



## Thirrje për krijimin e një liste referimi të ekspertëve

Shoqata e Punëtorëve Financiar të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ndërmarrjeve Publike (ShPF), merr pjesë në zbatimin e aktiviteteve nga projekti “Fuqizimi i Këshillave Komunal – Faza 2” (Empowering Municipal Councils – Phase 2)“, financuar nga qeveria Zvicerane, Ministria e vetëqeverisjes lokale, kurse e bashkëfinancuar dhe zbatuar nga Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara - UNDP. Projekti ka për qëllim që të vazhdojnë aktivitetet e filluara më parë për fuqizimin e komunave përmes këshillave komunal të fuqizuar, që janë të aftë të përmbushin në mënyrë efektive rolet e tyre të caktuara të përfaqësimit, mbikëqyrjes dhe respektimit të legjislacionit komunal, me përfshirjen e qytetarëve aktivë.

Për zbatimin e një pjesë të aktiviteteve të projektit, ShPF ka nevojë për angazhimin e **ekspertëve të Tipit A - ekspertë nga fusha shkencore, ekspertë të pavarur**; si dhe **të ekspertëve të Tipit B – ish këshilltarë komunal**, sipas fushave/moduleve:

- **Moduli 1: Qeverisja e mirë komunale (Municipal good governance);**
  - Një ekspert i Tipit A;
- **Moduli 2: Lufta kundër korrupsionit (Fighting corruption);**
  - Një ekspert i Tipit A;

**Një ekspert i Tipit B do të angazhohet për Modulin 1 dhe Modulin 2.**

- **Moduli 3: Përgatitja e buxheteve komunale, miratimi dhe ekzekutimi (Municipal budget preparation, adoption and execution);**
  - Një ekspert i Tipit A;
  - Një ekspert i Tipit B;
- **Moduli 4: Menaxhimi me detyrimet (dhe borxhet), prokurimet dhe të ardhurat (Management of liabilities (and incurring debt), procurement and revenues);**
  - Një ekspert i Tipit A, për fushën: **Menaxhimi me detyrimet (dhe borxhet)**; dhe për fushën **të Ardhurat**;
  - Një ekspert i Tipit A, për fushën: **Prokurimet**;
  - Një ekspert i Tipit B (për të tre fushat e specifikuar);
- **Moduli 5: Raportet financiare në NjVL dhe analiza e tyre (Financial reports of the local self-government units and their analysis)**
  - Një ekspert i Tipit A;
  - Një ekspert i Tipit B;
- **Moduli 6: Kontrolli financiar dhe auditimi (Financial control and audit)**
  - Një ekspert i Tipit A;
  - Një ekspert i Tipit B;
- **Moduli 7: Planifikimi hapësinor dhe urban (Spatial and urban planning)**
  - Një ekspert i Tipit A;
  - Një ekspert i Tipit B;
- **Moduli 8: Barazia gjinore (Gender equality)**
  - Ekspertiza (ekspertët e Tipit A) për Modulin 8 do të sigurohet nga UNDP dhe nga UNWOMEN
- **Moduli 9: Marrëdhëniet ndëretnike (Inter-ethnic relations)**
  - Një ekspert i Tipit A;



**Një ekspert i Tipit B do të angazohet për Modulin 8 dhe për Modulin 9.**

- **Moduli 10: Bashkëpunimi ndërkomunal (Inter-municipal cooperation)**
  - Një ekspert i Tipit A;
- **Moduli 11: Gjelbërimi, ofrimi i shërbimeve komunale, menaxhimi i krizave dhe ndërtimi i rezistencës (Green recovery, delivery of communal services, crisis management and resilience building).**
  - Një ekspert i Tipit A;

**Një ekspert i Tipit B do të angazohet për Modulin 10 dhe për Modulin 11.**

Angazhimi i të gjithë ekspertëve do të jetë në përputhje me kriteret e publikuara në faqen e ShPF-së: <https://zfr.org.mk/>

**Paralajmërim:** Për këtë thirrje nuk janë të përshtatshëm ekspertët me statusin e nëpunësve shtetërorë, publikë dhe administrativë, të cilët kanë krijuar marrëdhënie pune në organet e pushtetit shtetëror dhe lokal dhe në organet e tjera shtetërore të krijuara në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, si dhe në institucionet që kryejnë veprimtari me interes publik të përcaktuar me ligj, kurse të organizuara si agjenci, fonde, institucione publike dhe ndërmarrje publike të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit, si dhe nga komunat në Qytetin e Shkupit.

Nëse jeni të interesuar, Ju lutemi dërgoni një letër të shkurtër motivimi me një specifikim të detyrueshëm të modulit për të cilin aplikoni dhe Biografinë tuaj të përditësuar me një foto jo më vonë se në orën 16:00 të hënën më 12 shtator të vitit 2022, në e-mail adresën e mëposhtme: [zfr.veles@gmail.com](mailto:zfr.veles@gmail.com)